Vendi dhe data e organizimit të takimit publik

Elementi	Përcaktimi
Baza ligjore	Në zbatim të ligjit nr. 146/2014, veçanërisht neneve 6, 7 dhe 15 të tij, si dhe të ligjit nr. 139/2015, takimet publike organizohen për të garantuar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin vendimmarrës vendor.
Vendi	Takimi publik zhvillohet brenda territorit administrativ të Bashkisë Pustec. Vendi i saktë përcaktohet në njoftimin për konsultimin publik.
Të dhënat që publikohen	Data e zhvillimit; ora; vendi i organizimit; objekti i konsultimit publik.
Mjetet e publikimit	Faqja zyrtare e Bashkisë Pustec; faqja zyrtare e Bashkisë në Facebook; këndet e njoftimit publik në fshatrat e Bashkisë Pustec.
Zhvillimi i takimit	Në takim prezantohet projektakti dhe diskutohen komentet, sugjerimet dhe rekomandimet e qytetarëve, grupeve të interesit dhe aktorëve të tjerë lokalë, në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 139/2015 dhe nenin 7 të ligjit nr. 146/2014.
Kontakti	info@bashkiapustec.gov.al